



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 3923 Prot.,
110

Tiranë, më 30.8.2021

URDHËR

Nr. 544, datë 30.8.2021

**“PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FMAA” NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE NË FUSHËN E
KINEMATOGRAFISË DHE TË VEPRAVE TË TJERA AUDIOVIZUALE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”:

U R D H Ë R O J:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale”.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

